

Nuk ka arsye të ndalet procesi në gjysmë nga QZHM-ja në Qëllimet Globale

Nxënësit mund të fuqizohen të përdorin njohuri për të bërë ndryshime pozitive. Një mendimtar kreativ i cili mund të sfidojë ide dhe përmes bashkëpunimit ta thellojë kuptimin e tyre në çështje globale do ta drejtojë ndryshimin, të cilin planifikojmë ta shohim në botë.

Whāia te iti kahurangi ki te tūohu koe me he aunga teitei

“Synoje mjegullën më të lartë, sepse nëse e huq atë do të arrish një majen më të lartë (malit)”

Nuk ka arsye të ndalet procesi në gjysmë nga QZHM-ja në Qëllimet Globale

Lënda

Shkenca shoqërore, Edukim Qytetar, Gjeografi

Rezultatet e mësimi

- Njohja e informacioneve themelore rreth Qëllimeve Globale
- Të menduarit rreth impaktit të Qëllimeve Globale
- Lidhja e Qëllimeve Globale me Qëllimet për Zhvillim të Mijëvjeçarit

Përgatitja

- Ky mësim kërkon nga nxënësit të keni disa njohuri rreth Qëllimeve për Zhvillim të Mijëvjeçarit
- Ky mësim kërkon nga nxënësit ta kenë shikuar hyrjen e filmit të animuar Qëllimet Globale në www.globalgoals.org/worldlargestlesson
- Nëse ata nuk e kanë shikuar filmin e animuar, atëherë duhet të përshtatet mësimi dhe kjo pjesë të futet në hapin e dytë.
- Shtypni shtojca për aktivitete mësimore

Koha e përgjithshme

60 minuta

Mosha

11-14 vjeç

Nuk ka arsye të ndalet procesi në gjysmë nga QZHM-ja në Qëllimet Globale

Aktiviteti mësimor

5 minuta

Shikojeni këtë film të shkurtër për Panyee (gjatësia – 5:15) në

- <https://vimeo.com/2187455>
- <https://www.youtube.com/watch?v=jU4oA3kkAWU>

Ky është një film i shkurtër për formimin e klubit të futbollit Panyee. Ko Panyee është një ishull i vogël Tai. Filmi në fjalë tregon se përkundër mundësive reale, ishulli e ka formuar një ndër ekipet më të suksesshme në shtetin e tyre.

Kërkoni nga studentët të diskutojnë me partnerin e tyre (të çiftit) për këtë:

- Për çka flet filmi?
- Cilat kanë qenë të arriturat e njerëzve në film?
- Cilët kanë qenë faktorët të cilët i kanë shpirë fëmijët drejt arritjes së ëndrrave të tyre?
- Cila është porosia kryesore e filmit?

Diferencimi dhe alternativat

Nëse nuk keni qasje me internet ose me celular atëherë ndani me ta tregimin në shtojcën 1

Aktiviteti mësimor

5 minuta

Duke e përdor shtojcën 2, radhitni tetë Qëllimet për Zhvillim të Mijëvjeçarit (QZHM). Kjo nënkupton klasifikim të QZHM-së në qëllime më të rëndësishme dhe më pak të rëndësishme, duke i radhitur sipas formës së diamantit, ashtu që një qëllim shënohet në krye të diamantit ndërsa një qëllim shënohet në fund të tij (më pak i rëndësishëm), ndërsa disa të tjerë shënohen në mes, të gjithë të radhitur në formë të diamantit.

Mundësitë për klasifikim:

- Lokale
- Nacionale
- Globale
 - Sipas rëndësisë
 - Sipas rezultateve të arritura
 - Sipas veprimeve të ardhme

Nuk ka përgjigje të sakta ose jo të sakta. Në fakt qëllimi është që nxënësit të mendojnë dhe të diskutojnë rreth ideve të tyre.

Shpjegoni se Qëllimet Globale për zhvillim të qëndrueshëm paraqesin hapat vijuese të QZHM-së.

Diferencimi dhe alternativat

Si alternativë mund t'i pyetni nxënësit t'i radhitin tetë QZHM-të nga më të rëndësishmit kah më pak të rëndësishmit; ose pyetni t'i zgjedhin tre qëllimet më të rëndësishme; gjegjësisht pyetni cilat dy qëllime do t'i eliminonin dhe për çfarë arsye.

Nuk ka arsye të ndalet procesi në gjysmë nga QZHM-ja në Qëllimet Globale

Nxënësit më të vjetër dhe me më shumë përvojë do të mund t'i radhisin QZHM-të disa herë duke i përdorë të gjitha opsionet e mundshme e pastaj mund të diskutojnë nëse i kanë përcaktuar QZHM-të ndryshe dhe pse e kanë bërë atë klasifikim.

Aktiviteti mësimor

10 minuta

Kërkoni nga nxënësit të krijojnë një pikë bazë të hartës mendore ose një *rrjet diagrami* për Qëllimet Globale, ku do të harmonizohen idetë fillestare.

Më pas pyetni nxënësit të shënojnë gjithçka që dinë për Qëllimet Globale ose për problemet, të cilat shpresojnë t'i zgjidhin qëllimet.

Diferencimi dhe alternativat

Përveç kësaj mund t'i pyetni nxënësit të krijojnë rrjetin KWL (DDM) (*Di, Dëshiron të dijë dhe Mëson*). Ata duhet të vizatojnë tre kolona. Në kolonën e parë shënojnë gjithçka që dinë për Qëllimet Globale, ndërsa në kolonën e dytë gjithçka që duan të dinë për ta. Ata mund ta shtojnë kolonën e dytë gjatë zhvillimit të mësimi.

Në fund të mësimi kërkoni nga nxënësit ta kompletojnë kolonën e fundit me gjithçka që kanë mësuar për Qëllimet Globale.

Çfarëdo qoftë të jashtëzakonshme, 'që duan të dinë' do të mund ta formojë bazën e detyrës së hulumtimit ose bazën e mësimi të ardhshëm.

Aktiviteti mësimor

20 minuta

Takime të shpejta. Nxënësit janë të ndarë në grupe me nga 6 anëtarë. Secilit jepjani nga një kopje të shtojcës 3 dhe ndajani nga një temë secilit person. Ata kanë tre minuta ta lexojnë tekstin, ndërsa ju përkujdesuni ta kenë kuptuar gjuhën dhe të parashtrojnë ndonjë pyetje. Pastaj ndani nxënësit në grupet e tyre, ashtu që të kenë nga një minutë në dispozicion t'ia shpjegojnë njëri tjetrit temën e vetë. Pastaj nxënësit lëvizin nga çifti në çift dhe e dëgjojnë nga një partner tjetër temën e grupit. Derisa nxënësit e dëgjojnë partnerin duhet të shënojnë ndonjë fjalë ose ide kyçe.

Në fund të *takimit të shpejtë* të nxënësit duhet të kishin dëgjuar për secilën temë si dhe të mund t'i shtojnë fjalët kyçe dhe shënime në hartën mendore. Nëse është e mundshme nxënësit duhet t'i shkruajnë këta shënime me ngjyra ndryshe nga ngjyra e ideve dhe reagimeve të tyre fillestare.

Diferencimi dhe alternativat

Nxënësit mund po ashtu të përdorin aktivitetin "Botën që duam", si shpjegim të Qëllimeve Globale për fëmijë.

Nuk ka arsye të ndalet procesi në gjysmë nga QZHM-ja në Qëllimet Globale

Aktiviteti mësimor

5 minuta

Për çdo temë të Qëllimit Global pyetni nxënësit të mendojnë në lidhje me ndikimin e ardhshëm dhe shënoni idetë e tyre në hartën mendore. Fokusohuni në ndikimin pesëvjeçar, nëse vazhdojnë të ndiqen qëllimet.

Diferencimi dhe alternativat

Për nxënësit më të rritur ose më të aftë, ju do të mund t'i pyetni të mendojnë rreth ndikimit për një, pesë, dhjetë dhe pesëmbëdhjetë vjet – cili do të jetë dallimi?

Ju do të mund ta zgjeroni detyrën duke i pyetur ata të mendojnë rreth asaj se çka do të mund ta pengojë rezultatin pozitiv të Qëllimi Global?

Aktiviteti mësimor

10 minuta

Për të përfunduar mësimin, tregojani nxënësve 17 Qëllimet Globale në shtojcën 4 dhe 5. Kërkoni nga nxënësit ti klasifikojnë qëllimet sipas kritereve të njëjta të përdora me QZHM-në në fillim. A kanë paraqitur nxënësit klasifikime të ngjashme.

Kërkoni nga nxënësit t'i diskutojnë disa ose të gjitha nga pyetjet në vijim:

- Çka mendojnë ata si krahasohen Qëllimet Globale me QZHM-në?
- Cilat janë ngjashmëritë/dallimet?
- Idetë sesi Qëllimet Globale do të mund të jenë më të suksesshme se QZHM-të
- Kërkoni nga nxënësit të mendojnë në lidhje me tregimin që e shikojnë në fillim të mësimin dhe për Qëllimet Globale. Cila është lidhja mes tyre?
- Nxënësit mund në Fejsbuk ta ndajnë me të tjerët hartën mendore për Qëllimet Globale

Ndërmerrni masa për Qëllimet globale

Si edukator keni fuqinë t'i kanalizoni energjitë pozitive të nxënësve dhe t'iu ndihmoni atyre të besojnë se nuk janë të pafuqishëm, se ndryshimi është i mundshëm dhe se ata vetë mund ta drejtojnë atë.

Projekti për ndryshim “Unë mund t'iu dal ballë sfidave” i fton fëmijët të ndërmarrin veprime, të bëjnë ndryshime për moshatarët e tyre dhe t'i ndajnë ato me fëmijët anekënd botës.

Vizitoni www.dfcworld.com që të filloni

Për të zbritur një pako mësimesh të *projektit për ndryshim*, gjegjësisht një pako të thjeshtë këshillëdhënëse me të cilën të rinjtë do të mund të marrin ndonjë veprim vizitoni

www.globalgoals.org/worldslargestlesson

Nuk ka arsye të ndalet procesi në gjysmë nga QZHM-ja në Qëllimet Globale

KF Panyee

Panyee është një fshat i vogël i shtrirë në këmbalec mbi det në jug të Tajlandës. Në vitin 1986 një grup të rinjsh, që jetonin atje i sfiduan të gjithë dhe i inspiruan gjeneratat, që të ndërmarrin veprime të duhura. Sporti i vetëm që ka mund të luhet në Panyee ka qenë gara me anije dhe peshkimi, për shkak se fshati është krejtësisht i rrethuar me ujë.

Sidoqoftë djelmoshat absolutisht shumë dëshironin të shikojnë futboll. Një ditë njëri nga djelmoshat sugjeroi të hapin një ekip futboll. Djemtë vendosin ta formojnë atë dhe të mësojnë të bëhen kampionë. Fshatarët tjerë menduan se është ide qesharake dhe bënë shaka me ta. Asnjëherë një gjë e tillë nuk ishte bërë në Panyee, në fakt dukej e pamundshëm të hapet një ekip futboll në një fshat të shtrirë në këmbalec mbi ujë. Djelmoshat e kuptuan se fshatarët tjerë kishin të drejtë. Nuk kishte vend ku të stërviten ose të luajnë në fshat. Ata kishin një ekip, por nuk kishin fushë sporti. Për këtë arsye vendosën të ndërtojnë hapësirën e tyre për lojë.

Djelmoshat filluan të grumbullojnë dru të vjetër nga rrethina e fshatit dhe së bashku ndërtuan trape nga druri mbi ujë. Ata pas mbarimit të shkollës deri vonë punonin në sipërfaqen e re për lojë. Djelmoshat më në fund e mbaruan ndërtimin e fushës mbi sipërfaqen e trapeve, ndonëse sipërfaqja nuk ishte as e rrafshët e as e sigurt. Zgjatëshin gozha nga sipërfaqja. Shpeshherë topi binte në ujë, siç binin edhe vetë djelmoshat. Ata u mësuan të luajnë në sipërfaqe të lagur dhe të rrëshqitshme, mirëpo lëvizjet e tyre me top u zhvilluan mjaft për shkak të madhësisë së vogël të fushës së sportit. Banorët lokalë ende insistonin në qëndrimin se ata nuk do të mund të bëhen kampionë duke u stërvitur në sipërfaqe të lëkundshme.

Sidoqoftë një mëngjes njëri nga djelmoshat e pa një afishe në pjesën kontinentale të vendit, ku i shpallur organizmi i një turniri njëditor. Ekipi nuk ishte i sigurta nëse është sa duhet i përgatitur të aplikojë për të marrë pjesë, por megjithatë vendosën të regjistrohen. Djelmoshat nuk ishin të vetëdijshëm se banorët tjerë të fshatit i kishin shikuar ata duke u përgatitur. Të gjithë banorët kontribuan për blerje të fanellave sportive për në turnir, gjë që i befasoi djelmoshat. Disa nga fshatarët shkuan edhe të bëjnë tifo për djelmoshat.

Pasi filluan të zhvillojnë ndeshje, e kuptuan se paskan qenë më të mirë sesa kishin menduar për veten. Në gola të mëdha ishte më lehtë të shënojnë sesa në golat e tyre në Panyee, kështu që arritën deri në gjysmëfinale. Mirëpo ndeshja filloi keq për shkak se binte shi, por edhe ekipi tjetër ishte shumë i talentuar. Atletet e djelmoshave të Panyee-it u mbushën me ujë dhe filluan t'u rëndojnë. Deri në mbarim të pjesës së parë ekipi kundërshtar avanconte me dy gola. Ekipi filloi të dëshpërohet dhe nuk dinte se çka të bëjë.

Në pjesën e dytë ata vendosën t'i heqin atletet. Për ta ishte më e natyrshme të luajnë këmbëzbathur, sikurse luanin në shtëpi, pasi ashtu mund të luanin më shpejtë. Shumë shpejt e barazuan rezultatin. Edhe pse ekipi kundërshtar arriti të fitojë dukë shënuar një gol në minutën e fundit, fshati Panyee ishte shumë krenar për ekipin e tyre. Menjëherë futbollit u bë sporti numër një në Panyee. Fshatarët e ndërtuan një fushë sporti të rrafshët, ku do të mund lojtarët të bënin stërvitje. KF Panyee tani konsiderohet si një ndër klubet më të mira në Tajlandën jugore, duke fituar titujt e kampionëve për juniorë në vitin 2004, 2005, 2006, 2007, 2008, 2009 dhe 2010.

Nuk ka arsye të ndalet procesi në gjysmë nga QZHM-ja në Qëllimet Globale

Qëllimet për Zhvillimin e Mijëvjeçarit

1. ZHDUKJA E VARFËRISË EKSTREME
2. ARRITJA E ARSIMIT FILLOR UNIVERSAL
3. PROMOVIMI I BARAZISË GJINORE DHE FUQIZIMI I GRAVE
4. ZVOGËLIMI I MORTALITETIT TË FËMIJËVE
5. PËRMIRËSIMI I SHËNDETIT TË MATERNITETIT
6. LUFTA KUNDËR HIV/SIDA, MALARIES DHE SËMUNDJEVE TJERA
7. SIGURIMI I QËNDRUESHMËRISË SË MJEDISIT JETËSOR
8. PARTNERITETI GLOBAL PËR ZHVILLIM

QZHM 1: Zhdukja e varfërisë ekstreme

QZHM 2: Arritja e arsimit fillor universal

QZHM 3: Promovimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave

QZHM 4: Zvogëlimi i mortalitetit të fëmijëve

QZHM 5: Përmirësimi i shëndetit të maternitetit

QZHM 6: Lufta kundër HIV/SIDA-s, malaries dhe sëmundjeve tjera

QZHM 7: Sigurimi i qëndrueshmërisë së mjedisit jetësor

QZHM 8: Partneriteti global për zhvillim

Preni qëllimet dhe klasifikoni sipas rëndësisë së tyre

Nuk ka arsye të ndalet procesi në gjysmë nga QZHM-ja në Qëllimet Globale

Qëllimet Globale për Zhvillim të Qëndrueshëm

Tema 1: Varfëria (Qëllimi Global 1 – Jo varfërisë; Qëllimi Global 10 – Reduktimi i pabarazive

Synimet e Qëllimeve Globale 1 dhe 10

- Zhdukja e varfërisë ekstreme për të gjithë njerëzit kudo në botë. Vlerësohet se njerëzit jetojnë me më pak se 1.25 \$ në ditë.
- Të sigurohet se të gjithë meshkujt dhe femrat të kenë të drejta të barabarta për resurse ekonomike, pronë dhe kontroll të tokës dhe forma tjera të varfërisë dhe trashëgimisë.
- Të krijohen mundësi për rimëkëmbje të të varfërve dhe të personave vulnerabil, të reduktohet ekspozimi i tyre ndaj ndikimeve ekstreme që kanë të bëjmë me klimën.
- Të fuqizohet dhe promovohet inkluzioni social, ekonomik dhe politik i të gjithëve pavarësisht nga mosha, gjinia, paaftësitë, raca, etnia, origjina ose religjioni.
- Të lehtësohet migrimi dhe lëvizja e drejtë, e sigurt dhe përgjegjshme e njerëzve, përfshirë implementimin e plotë të politikave të planifikuara dhe të menaxhuara mirë rreth çështjes së migracionit.

Pse?

- 85 personat më të pasur në botë kanë shumë më tepër të holla sesa gjysma e personave më të varfër (3.5 miliard banorë) të botës. (Oksfam, Mbretëria e Bashkuar, 2014)

Tema 2: Shëndeti personal dhe mirëqenia (Qëllimi Global 2 – Jo varfërisë; Qëllimi Global 3 – Shëndeti i mirë; Qëllimi Global 6 – Uji i freskët dhe instalimet hidrosanitare

Synimet e Qëllimeve Globale 2, 3 dhe 6

- Të mbarojë uria dhe të sigurohet qasje nga të gjithë njerëzit, në veçanti nga të varfrit dhe personat në situata vulnerabile, duke përfshirë edhe foshnjat për ushqim të sigurt dhe të mjaftueshëm gjatë tërë vitit.
- Të mundësohen sisteme për prodhim të qëndrueshëm të ushqimit dhe të zbatohen praktika për rimëkëmbje bujqësore, të cilat e rrisin prodhimtarinë dhe prodhimin, gjë që ndihmon në mirëmbajtjen e ekosistemeve dhe në mënyrë progresive e përmirëson cilësinë e tokës dhe dheut.
- Të reduktohet përmasa e mortalitetit të lindjeve në nivel global në më pak se 70 nga 100 000 lindje.
- Të parandalohen vdekjet e foshnjave dhe fëmijëve nën moshën pesë vjeçare.
- Të arrihet qasje universale dhe e barabartë për ujë të sigurt dhe të pijshëm për të gjithë.
- Të arrihet qasje adekuate dhe e barabarta në pajise hidrosanitare si dhe higjienë për të gjithë, duke iu kushtuar vëmendje të posaçme nevojave të grave dhe vajzave.

Pse?

Nuk ka arsye të ndalet procesi në gjysmë nga QZHM-ja në Qëllimet Globale

- Uria kronike vazhdon të prekë më shumë se 870 milion njerëz, gjë që reflektohet me dominim të lartë të fëmijëve të rrëgjuar dhe indikatorëve tjerë të urisë. Po ashtu, sëmundjet serioze nga mosushqimi kanë efekt ndaj qindra milion njerëzve. Llogaritet se rreth 3 milion fëmijë nën moshën 5 vjeçare vdesin çdo vit si rezultat i mosushqimit të duhur. (<http://unsdsn.org/resources/goals-and-targets/>).

Nuk ka arsye të ndalet procesi në gjysmë nga QZHM-ja në Qëllimet Globale

Tema 3: Arsimi, shkathtësitë dhe puna (Qëllimi Global 4 – Arsimi cilësor; Qëllimi Global 8 – Puna e mirë dhe rritja ekonomike)

Synimet e Qëllimeve Globale 4 dhe 8

- Të sigurohemi që të gjithë vajzat dhe djemtë të kenë arsimin fillor dhe të mesëm falas dhe cilësor, që shpie drejt rezultateve relevante mësimore.
- Të sigurohet qasje e barabartë për të gjithë gratë dhe burrat në arsim të mundshëm cilësor teknik, profesional dhe terciar, përfshirë edhe arsimin universitar.
- Të eliminohen disparitetet gjinore në arsim dhe të sigurohet qasje e barabartë në të gjitha nivelet e arsimit dhe trajnimit profesional për personat vulnerabil, përfshirë edhe ata me ndonjë paaftësi, banorët indigjenë dhe fëmijët në situata vulnerabile.
- Të arrihet nivel më i lartë i produktivitetit ekonomik përmes diversitetit, avancimit teknologjik dhe inovacioneve
- Të arrihet punësim i plotë, produktiv dhe punë të denjë për të gjitha gratë dhe burrat, përfshirë të rinjtë dhe personat me paaftësi, si dhe pagesë të barabartë dhe vlerësim të barabartë.

Pse?

57 milion fëmijë nuk ndjekin mësimin në shkollë, 31 milion prej tyre janë vajza. Nga këta 57% milion 49% me siguri kurrë nuk do të futen në ambientet e shkollës, më shumë se 50% të këtyre 57 milionëve janë nga rajoni i Afrikës nën shkretëtirën e Saharës.

(http://en.unesco.org/post2015/sites/psot2015/files/Making_Education_a_Priority_in_the_Post-2015_Development_Agenda.pdf).

Tema 4: Një botë e drejtë (Qëllimi Global 5 – Barazia gjinore; Qëllimi Global 16 – Drejtësia dhe paqja)

Synimet e Qëllimeve Globale 5 dhe 16

- Të zhduken të gjitha format e diskriminimit kundër të gjitha grave dhe vajzave anekënd botës,
- Të eliminohen të gjitha format e dhunës kundër grave dhe vajzave në sferën publike dhe private, përfshirë trafikimin dhe eksploatimin seksual dhe format tjera të abuzimit
- Të mundësohet pjesëmarrje e plotë dhe efektive e grave dhe mundësi e barabarta për lidhshmëri në të gjitha nivelet e marrjes së vendimeve në jetën politike, ekonomike dhe publike.
- Në masë të konsiderueshme anekënd botës të reduktohen të gjitha format e dhunës dhe vdekjeve si pasojë e saj

Nuk ka arsye të ndalet procesi në gjysmë nga QZHM-ja në Qëllimet Globale

Pse?

- Në rajonin e Afrikës nën shkretëtirën e Saharës, në Azinë perëndimore dhe në Azinë jugore, djemtë ende në masë të konsiderueshme janë më shumë të përfshirë sesa vajzat në arsimin e mesëm dhe atë terciar?
- Në nivel global gratë ende zënë më pak se një të katërtën e ulëseve në parlament. (<http://www.theguardian.com/global-development/2015/mar/26/millennium-development-goal-three-gender-equality-explainer>)

Tema 5: Qëndrueshmëria (Qëllimi Global 7 – Energjia për të ardhmen; Qëllimi Global 9 – Infrastruktura e fortë; Qëllimi Global 11 – Mjediset e sigurta; Qëllimi Global 12- Jeta e qëndrueshme; Qëllimi Global 17 – Partneriteti për të ardhmen)

Synimet e Qëllimeve Globale 7, 9, 11, 12 dhe 17

- Të mundësohet qasje universale në shërbime të arritshme, të besueshme dhe moderne të energjisë elektrike.
- Të zhvillohet infrastrukurë cilësore, e qëndrueshme dhe e renovueshme për mbështetjet të zhvillimit ekonomik dhe mirëqenies njerëzore, me fokus në qasje të arritshme dhe të barabartë për të gjithë.
- Të sigurohet akomodim dhe shërbime themelore adekuate, të sigurta dhe arritshme për të gjithë, si dhe të përmirësohet infrastrukura e lagjeve të varfra.
- Të arrihet menaxhim i qëndrueshëm dhe përdorimi efikas i resurseve natyrore.
- Të përgjysmohen mbeturinat e ushqimit për kokë banori anekënd botës në nivel të shitjes me pakicë dhe nivelit të konsumatorëve, gjegjësisht të reduktohen humbjet e ushqimit gjatë prodhimit të ushqimit dhe furnizimit.
- Të respektohet politikat e shteteve dhe hapësira e udhëheqësve në drejtim të themelimit dhe implementimit të politikave për zhdukje të varfërisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Pse?

- Llogaritet se ende në vitin 2015 rreth 2.8 milion njerëz nuk kanë qasje në shërbime moderne të energjisë dhe mbi 1.1 miliard tjerë nuk kanë rrymë elektrike. Po ashtu për çdo vit rreth 4.3 milion banorë vdesin më herët si rezultat i ndotjes së ambienteve ku jetojnë, për shkak të gatimit dhe nxehtësisë me lëndë djegëse të paqëndrueshme.

Tema 6: Mjedisi jetësor (Qëllimi Global 13 – Mbrojtja e planetit; Qëllimi Global 14 – Jeta në ujë; Qëllimi Global 15 – Jeta në tokë)

Synimet e Qëllimeve Globale 13, 14 dhe 15

- Të fuqizohen kapacitetet regjeneruese dhe të përshtatshme të rreziqeve që kanë të bëjnë me klimën dhe fatkeqësitë natyrore në të gjitha shtetet.
- Të parandalohen dhe në masë të konsiderueshme të reduktohen të gjitha llojet e ndotjes së detit, në veçanti ato të shkaktuara nga aktivitete nga pjesa kontinentale.

Nuk ka arsye të ndalet procesi në gjysmë nga QZHM-ja në Qëllimet Globale

- Të rregullohet në mënyrë efektive dhe të përfundojë peshkimi i tepërt dhe ilegal, si dhe praktikatat e paraportuar dhe të parregulluara të peshkimit,
- Të promovohet implementimi i menaxhimit të qëndrueshëm të të gjitha llojeve të pyjeve, të ndërpritet shkatërrimi i pyjeve dhe të pyllëzohen pyjet e dëmtuara.
- Të ndërmerren veprime urgjente dhe të rëndësishme për degradim të habitateve natyrore dhe të ndërpritet humbja e biodiversitetit.

Pse?

- Rreth 60% të ekosistemit detar përdoret pa qasje të qëndrueshme ose degradohet si rezultat i peshkimit të tepërt, ndotjes, ngrohjes, ngritjes së nivelit të detit, acidimit si rezultat i rritjes së koncentrimin të dyoksidit të karbonit (CO₂) në atmosferë të shkaktuar nga njeriu. (<http://unsdns.org/resources/goals-and-targets/>)

Nuk ka arsye të ndalet procesi në gjysmë nga QZHM-ja në Qëllimet Globale

**QËLLIMET GLOBALE
për zhvillim të qëndrueshëm**

- 1 Jo varfëria**
- 2 Jo uria**
- 3 Shëndeti**
- 4 Arsimi cilësor**
- 5 Barazia gjinore**
- 6 Uji i pastër dhe instalimet hidrosanitare**
- 7 Energji e renovueshme**
- 8 Puna e mira dhe rritja ekonomike**
- 9 Inovacioni dhe infrastruktura**
- 10 Zvogëlimi i pabarazive**
- 11 Qytete dhe bashkësi të qëndrueshme**
- 12 Konsumimi i përgjegjshëm**
- 13 Mbrojtja e planetit**
- 14 Jeta nën ujë**
- 15 Jeta në tokë**
- 16 Paqja dhe drejtësia**
- 17 Partneriteti për qëllimet**

QËLLIMET GLOBALE

Nuk ka arsye të ndalet procesi në gjysmë nga QZHM-ja në Qëllimet Globale

**QËLLIMET GLOBALE
për zhvillim të qëndrueshëm**

- 1 Jo varfëria**
- 2 Jo uria**
- 3 Shëndeti**
- 4 Arsimi cilësor**
- 5 Barazia gjinore**
- 6 Uji i pastër dhe instalimet hidrosanitare**
- 7 Energji e renovueshme**
- 8 Puna e mira dhe rritja ekonomike**
- 9 Inovacioni dhe infrastruktura**
- 10 Zvogëlimi i pabarazive**
- 11 Qytete dhe bashkësi të qëndrueshme**
- 12 Konsumimi i përgjegjshëm**
- 13 Mbrojtja e planetit**
- 14 Jeta nën ujë**
- 15 Jeta në tokë**
- 16 Paqja dhe drejtësia**
- 17 Partneriteti për qëllimet**

QËLLIMET GLOBALE